



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Mekanismi Parandalues Nacional (MPN) më datë **19.12.2014** realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Burgun Kumanovë. Kjo vizitë u zbatua në kuadër të mandatit dhe kompetencave të cilat burojnë nga Protokollit Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese dhe Ligji për Avokatin e Popullit. Në përbërje të Mekanizmit Parandalues Nacional u përfshi edhe bashkëpunëtori i jashtëm i Shoqatës për të Drejtën Penale dhe Kriminologji në bazë të nënshkrimit paraprak të Memorandumit për bashkëpunim.

Qëllimi i vizitës, konform Protokollit Fakultativ i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Jonjerëzore, Nënçmuese dhe Ndëshkuese, është identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës ose trajtimeve tjera brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Burgu Kumanovë, me Repartin e Hapur në Kriva Pallankë, është institucion ndëshkues – korrektues i llojit gjysmë të hapur në të cilin elementar është sigurimi fizik, të cilin e realizojnë anëtarët e Sektorit të Sigurimit. Dënimin e vuajnë personat-meshkuj-kryerës primarë, të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burgim deri në 3 vjet, përkatësisht kur pjesa tjetër e dënimit, pas përlllogaritjes së paraburgimit, është deri në 3 vjet, si dhe persona meshkuj recidivistë, të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me dënim me burgim deri në 6 muaj, përkatësisht kur pjesa tjetër e dënimit, pas përlllogaritjes së paraburgimit, është deri në 6 muaj. Në Burgun Kumanovë ekziston edhe pjesa e paraburgimit, ndërsa gjatë kohës së vizitës në të ishin vendosur 32 persona të paraburgosur.

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional në fillim të vizitës bisedoi me kryeshefin e policisë së burgut, ndërsa më pas bëri këqyrje në Repartin e Paraburgimit, dhomat e izolimit, Repartin e Pranimit, Repartin e Mbyllur të burgut, Repartin Gjysmë të Hapur dhe të Hapur, hapësirën për takime me avokatët, nyjat sanitare në të gjitha repartet e pjesës së paraburgimit dhe burgimit, ambulancë, kuzhinë, mensë dhe hapësira tjera.

Gjatë vizitës u zhvilluan biseda me personat e privuar nga liria edhe atë me disa persona të paraburgosur, me personat e vendosur në dhomat e izolimit, me personat në Repartin e Pranimit, me personat e vendosur në Repartin Gjysmë të Hapur, të Hapur dhe Repartin e Mbyllur.

Sa i përket trajtimit nga ana e ana e sektorëve, personat e dënuar paraqitën vërejtje për Sektorin për Risocializim, me ç'rast thanë se ky sektor vepron vetëm nëse personat e dënuar kërkojnë një gjë të këtyllë, gjithashtu nuk zbatohen aktivitete plotësuese, e as nuk realizohet proces i organizuar për risocializim nga ana e ekipit i cili e udhëheq këtë Sektor. U konfirmua se nuk ka dhunë midis personave të dënuar, por shqetëson fakti se repartet kombinohen me kategori të ndryshme të personave të dënuar, përkatësisht se ekziston kontakt i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë midis personave nga Reparti Gjysmë i Hapur dhe i Hapur.

Brengos edhe fakti se Burgu Kumanovë, edhe pse është objekt i ri, nuk disponon me punëtori, në të cilat do të mund të përfshiheshin personat e dënuar, e as nuk ka njësi ekonomike të cilat do të mund të përdoreshin për aktivitete bujqësore. Gjatë stinës së verës një pjesë e vogël e personave të dënuar ishin angazhuar në firmat fqinje, të cilat janë në afërsi të drejtpërdrejtë me burgun. Gjatë kohës së vizitës vetëm 4 persona të dënuar ishin të angazhuar me punë jashtë burgut. Në burg, personat e dënuar angazhohen në kuzhinë, ndërsa dy persona të dënuar janë përgjegjës për rregullimin e bibliotekës dhe evidencën e librave të cilat i ka në dispozicion burgu.

Në Burgun Kumanovë, në përputhje me ndryshimet e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, mbrojtjen shëndetësore e zbaton mjeku nga IPSH Shtëpia e Shëndetit Kumanovë, i cili vjen dhe kryen kontrole çdo ditë të martë dhe të premte, ndërkohë që ka të angazhuar edhe infermiere e cila është përditë në burg dhe e ndan terapinë. Njëkohësisht, ditën e premte, personat e privuar nga liria i viziton stomatologu ndërsa, në marrëveshje me spitalin e Kumanovës, dy herë në javë kryhen vizita edhe nga psikiatri. Për raste urgjente, kur nuk ka mjek në burg, thirret ndihma e shpejtë.

Sa i përket arsimit profesional dhe trajnimit, gjithashtu të njëjtët nuk realizohen, ndërsa hapësirat/punëtoritë të cilat janë dedikuar për këtë qëllim nuk janë të pajisura dhe të njëjtat nuk mund të shfrytëzohen. Burgu ka klasa, por të njëjtat nuk shfrytëzohen ndërsa, në mënyrë shtesë, në burg pajiset biblioteka e cila tashmë ka siguruar fond të madh të librave. Në burg mungojnë edhe instruktorët, përkatësisht ka vetëm një të punësuar – kuzhinier instruktor, i cili mund t'i mësojë personat e dënuar me shkathtësitë e gatimit.

Personat në Repartin Gjysmë të Hapur dhe të Hapur kanë mundësi të qëndrojnë në ambient të hapur në shëtitore, por një pjesë e ankesave kishin të bënin me aplikimin jo të plotë të trajtimit të hapur, përkatësisht se personat e dënuar mbahen të kyçur në repartet e tyre dhe nuk janë plotësisht të lirë, në aspekt të daljes dhe shëtitjeve jashtë objektit të burgut. Këto ankesa, në pjesën më të madhe, u paraqitën nga personat e dënuar në ENK "Idrizovë", të cilët qëndrojnë në Repartin e Hapur, i cili është jashtë mureve të sigurisë dhe ku personat e dënuar kanë mundësi që për periudhë më të gjatë kohore të qëndrojnë jashtë.

Gjatë vizitës, ekipi i MPN realizoi këqyrje në disa libra dhe evidenca dhe konstatim i përgjithshëm është se regjistrat, përkatësisht udhëheqja e librave në Burgun Kumanovë është në nivel të kënaqshëm. Burgu mban evidencë të posaçme për përdorimin e forcës fizike dhe mjeteve të shtrëngimit, si dhe për ndëshkime disiplinore dhe në këtë evidencë nuk vërehet përdorimi i prangave të cilat shfrytëzohen për shoqërim, e as ndarjen si mjet detyrimi.

Si rezultat i vizitës të rregullt të realizuar pa paralajmërim, Mekanizmi Parandalues Nacional përgatiti raport të veçantë në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe Burgut Kumanovë.